



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT "ERMIR GODAJ"

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Qendra Torre Drin, kati 2, Nr.33, Tirane

Cel. 0684054605 / 0682099471 email: ermirgodaj@mail.com

Nr. 3201 /Prot.

Tirane, me 27/04 /2021

URDHER
PER VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendres Kombetare te Biznesit

TIRANE

Une Ermir GODAJ permbarues gjyqesor privat, i pajisur me Çertifikate Nr.82 Maj 2012 dhe me Nipt L217160221, pasi studiova materialet e dosjes permbarimore Nr.2132/Rregj., bazuar ne Urdherin e Ekzekutimit Nr.2920Akti date 17.06.2020 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

KONSTATOVA:

Se me date 07.10.2020 eshte depozituar prane permbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj kerkesa e kreditorit Shoqerise "ART-KONSTRUKSION " Sh.p.k., e perfaqesuar me autorizimin e dates 05.10.2020 nga Av.Petra Gusho, se bashku me Urdherin e Ekzekutimit, te leshuar per Titujt ekzekutiv, Faturat Tatimore të Shitjes Nr.1686, date 06.07.2018 dhe Nr.2225, date 13.09.2018 të lëshuara nga Shoqëria Art-Konstruksion Sh.p.k. kundër Shoqërisë "RA KROM-TIRANA", sh.p.k. me Nipt K88016902A, me pale dhe objekt:

Kreditor: Shoqeria "ART-KONSTRUKSION" Sh.p.k.

Debitor: Shoqeria "RA KROM-TIRANA" Sh.p.k.

Objekti : Pagim Shume

Ne kushtet kur ekzekutimi i titullit ekzekutiv me vendimin e permbaruesit gjyqesor ka kaluar ne ekzekutim te detyrueshem dhe per ekzekutimin e tij duhet te kryhet bllokimi i pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe kredi tek te trete ne pronesi te debitorit.

Sa me sipër ne zbatim te neneve 519 , 527 e vijues te K.Pr.civile.

URDHEROJ:

Qendren Kombetare te Biznesit, te vendose masen e sekuestros konservative mbi pasurine e debitorit, si me poshte:

- **Te vendose sekuestro konservative mbi kapitalin qe zoteron debitori Shoqëria "RA KROM-TIRANA" sh.p.k. pajisur me Nipt K88016902A;**

ne menyre qe te mos kryhet asnje veprim tjetersimi apo disponimi.

Per veprimet apo mosveprimet tuaja na vini ne dijeni shkreserisht brenda 10(dhjete) ditesh.

Personat qe behen pengese,do te pergjigjen ne baze te nenit 606 te K.Pr.Civile (parag.II) qe parashikon vendosjen e sanksionit te gjobes dhe kallzimin penal.

PERMBARUESI GJYQESOR

Ermir GODAJ

